



HAPET THIRRJA PËR OFRUES SHËRBIMI PËR PUSHIM KAFEE- PROJEKTI “TË RINJ AKTIVË PËR DEMOKRACI QYTETARE 2”

Titulli:	Ofrues shërbimi për pushim kafe në Patos
Vendndodhja:	Patos
Fillimi i kontratës:	16.10.2023
Përfundimi i kontratës:	30.06.2024

Përshkrimi i situatës

Situata aktuale në Shqipëri, pavarësisht përmirësimeve, vazhdon të tregojë një diferencë të konsiderueshme për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe komuniteteve të marginalizuara në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Shkaku kryesor i kësaj mangësie varion nga pabarazia gjinore tek mungesa e kapaciteteve dhe programeve të institucioneve për t'u ofruar brezave informacion të saktë mbi procesin e vendimmarrjes dhe demokracinë qytetare. Në këtë situatë, iniciativat e arsimit joformal paraqesin mundësi shtesë për të përmbushur nevojat e komuniteteve të pashërbyera, për të promovuar angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Duke marrë parasysh situatën e sipërpërmendur, Qendra po zbaton projektin "*Të rinj aktivë për demokraci qytetare 2*", në Bashkinë Patos. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të nxisë dhe promovojë angazhimin qytetar të të rinjve përmes pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale.

Objektivat

Qendra Europiane është duke kërkuar një Ofrues shërbimi (bar, restorant ose market), për të ofruar pushim kafe për të rinjtë e Forumit Tematik Rinor. Grupi i të rinjve varion nga 15-20 persona dhe shërbimi do të ofrohet pranë ambienteve të Bashkisë Patos [TregART]. Nr. i eventeve mund të variojë nga 1-8 evente.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Më konkretisht, detyrat dhe përgjegjësitë e kërkuara nga Ofruesi i shërbimit janë si më poshtë:

- Të ofrojë pushim kafeje për 15-20 persona të grupmoshës 15-20 vjeç;
- Variacion produktesh, duke përfshirë:
 - pije jo-alkoolike (10 copë nga 330 ml) me gaz ose pa gaz, çaj (10 copë nga 330 ml), ujë (20 copë nga 0,5l)
 - snacks (20 copë) : kek, biskota, sanduiçë të vegjël, ose molto, bakerolls, çibukë, patatina.
- Servise për katering sipas rastit:
 - Peceta, mbulesë tavoline, pipa, gota dhe pjata plastike.
- Shërbim transporti dhe servirje pranë Sallës së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Patos.
- Nëse shërbimi do të përsëritet për disa aktivitete, preferohet variacion në produkte.



Kriteret e nevojshme

- Subjekti duhet të jetë i regjistruar pranë autoriteteve fiskale;
- I pajisur me numër NIPT-i.
- Të ofrojë shërbimet e tij në Bashkinë Patos;
- Të ketë kapacitetet e nevojshme për të mbuluar transportin dhe servirjen e produkteve;
- Të ketë produkte të certifikuara dhe të kontrolluara nga AKU ose agjenci të tjera përkatëse.

Oferta financiare

- Ofruesi i shërbimit është i lutur të dërgojë një version menuje me nje vlerë fianciare.
- Në rast dakordësimi, Ofruesi i shërbimit do të njoftohet me e-mail.

Të gjithë të interesuarit janë të lutur të dërgojnë menunë e tyre për shumën e lartëpërmendur deri në datën 10 tetor 2023 në adresën e emailit eupeancentrefoundation@gmail.com ose nëpërmjet postës në adresën rruga Vaso Pasha, Pl. 20/57, Tiranë, Shqipëri.